

Edhe të afërmit e familjes duhet të jenë pak a shumë të ndjeshëm ndaj tij.

Nëse do të shkonin mysafirë tek familja që sapo u ka lindur foshnja me dhurata, do ishte mirë që t'i përkushtoheshin edhe fëmijës më të rritur me një dhuratë sado simbolike.

Për foshnjën në shtrat nuk ka shumë rëndësi sesa mysafirët mund t'i përkushtohen, ndërsa për atë që është më i rritur ka.

## Të dashur prindër !

Tregojini fëmijës tuaj gjithë vëmendjen dhe dashurinë e duhur. Jepini atij mundësinë të ndiejë se është më i rrituri por jo duke lejuar sjellje të papërshtatshme. Jini të qëndrueshëm në qëndrimet tuaja, por pa treguar inat dhe nerva.



## Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

**Material konsultues për  
prindërit mbi  
shqetësimet e fëmijëve  
si pasojë e ardhjes në  
familje të një fëmije të  
dytë.**

**Adresa: Rruga e Barrikadave.  
Nr.tel. 04222991**



Ardhja e një anëtari të ri në familje ndodh që shkakton probleme mes fëmijëve të tjerë.

Në gjysmën e dytë të shtatzanisë është e domosdoshme që prindërit ta parapërgatitin fëmijën e parë me qëllim që lindja e vëllait apo e motrës të mos i vijë si 'rrufe në qiell të hapur'.

Nëse prindërit nuk do ishin në gjendje të vendosin veten në situatat e fëmijëve më të rritur atëherë ata mund të provokojnë ndjenjat e xhelozisë/ zilisë për vëllain ose motrën e vogël.

### **Këtë situatë prindërit duhet të dinë si ta kuptojnë.**

Prindërit duhet të kuptojnë se fëmija i parë, të cilit i është kushtuar e gjithë vëmendja dhe dashuria, tani mund të njuhet si i lënë mbas dore duke mos e mirëpritur siç duhet vëllain ose motrën e vogël.

### **Si duhet të sillen prindërit për të ndihmuar fëmijët të përshtaten me situatën e re?**

Përfshijeni fëmijën tuaj më të rritur sa më shumë gjatë punëve të parapregatitjes si gjatë blerjes, palosjes së rrobave të bebit, rregullimit të krevatit të foshnjës, etj.

Krijojini hapësirë fëmijës më të rritur që të mbledhë dhe vendosë në një vend të sigurt gjërat dhe lodrat e tij/ e saj më qëllim që "bebi të mos i prekë".

Lejojeni që të zgjedhë disa lodra për fëmijën e ri qofshin të tijat/sajat ose dhe duke i blerë të reja në dyqan.

Gjatë shtatzanisë ndodh që nëna të jetë e lodhur, e stresuar, të ketë dhimbje. Shqetësimet që transmeton nëna e bëjnë fëmijën të ndjehet i/e shqetësuar, i/e frikësuar, i/e pasigurt në vetvete. Në këtë mënyrë është e këshillueshme që nëna të mos ankohet në sy të fëmijës pasi ky i fundit do nisë të urrejë foshnjën, sepse e sheh si shkaktar të dhimbjeve të nënës.



Gjithashtu babai mund të merret më shumë në shtëpi me fëmijën me qëllim që tek ai të mos krijohen ndjenja frike ose vetmie. Tashmë dhe vëmendja e nënës është më shumë tek i sapolinduri dhe babai mund të jetë më i pranishëm duke qëndruar në shtëpi, madje do ishte mirë, të merrte disa ditë pushim.

Mos harroni të ledhatoni vazhdimisht fëmijën e rritur duke e lejuar që të qëndrojë bashkë me ju në ndërrimin e pelenave, në larjen e foshnjës. Situata të tilla i japin arsye të mendojë që nuk është i lënë mbas dore.

Bisedoni dhe flisni me fëmijën tuaj për gjithçka që i sapolinduri nuk e bën dot p.sh: "Beni nuk e kap dot topin, makinën, ai nuk mund të ecë, nuk mund të flasë etj. Ai duhet të mësojë shumë duke e ndihmuar edhe ti".

Shumë fëmijë i ngacmon dhe i mërzit sjellja e foshnjës duke reaguar me të qara dhe agresivisht. Në këtë rast prindërit duhet të flasin me të për ndjenjat e tij duke e ndihmuar që t'i shprehë ato.